

Mire se ardhët në Mbretërinë e Bashkuar



Edukimi në Mbretërinë e Bashkuar

Detaje të plota për të gjitha çështjet e përfshira në këtë broshurë mund të gjenden në "Prindërimi në Mbretërinë e Bashkuar", mësimi elektronik, në faqen e internetit të Partneritetit për Emigracionin në Veri-Lindje të Mbretërisë së Bashkuar. www.nemp.org.uk



Të gjithë prindërit duan që fëmijët e tyre të jenë të sigurt, të shëndetshëm dhe të lumtur me mundësi për të ardhmen e tyre. Por ata përballen me shumë sfida në një vend të ri, ku ka ligje të ndryshme, sisteme të ndryshme, pritsmeri të ndryshme dhe natyrisht një gjuhë tjetër. Kjo broshurë jep informacion të rëndësishëm rreth sistemit të edukimit në Mbretërinë e Bashkuar, për t'ju ndihmuar të mbështesni, mësimin dhe të ardhmen e fëmijës tuaj. Ky informacion u perzgjodh nga njerëz që kanë kërkuar azil në Mbretërinë e Bashkuar, bazuar në atë që ata do të kishin dashur të dinin, kur arritën për herë të parë.

Edukimi në Mbretërinë e Bashkuar

Viti shkollor zgjat nga shtatori deri në korrik, me 3 sezone - vjeshta, pranvera dhe vera - të ndara me nga me një jave pushim. Shkollat funksionojnë nga e hëna në të premten, duke filluar nga ora 9 e mëngjesit dhe duke mbaruar në orën 16:00 mbasdite.

Fëmijët 3 dhe 4 vjeç mund të ndjekin sistemin parashkollor - të quajtur "nursery," për 15 orë në javë, gjatë kohës që shkolla është aktive, gjë që ndihmon në përgatitjen e tyre për shkollë. Ky shërbim është falas. Pastaj, sipas ligjit në Mbretërinë e Bashkuar, fëmijët janë të detyruar të ndjekin arsimin me kohë të plotë, ndërmjet moshave 5 dhe 16 vjeç, dhe për fëmijët mbi 16 dhe 18 vjeç duhet të jenë në një formë arsimi ose trajnimi.



Arsimi është falas në shkollat e financuara nga shteti. Shumica janë shkolla të përziera, duke mësuar djem dhe vajza së bashku.



Nga prindërit kërkohet me ligj që të sigurojnë që fëmija i tyre të shkojë në shkollë. Nuk është zgjidhje. Duke munguar në shkollë do të thotë që fëmija të mbetet prapa në mësim. Prindërit duhet të synojnë pjesëmarrjen 100%. Ju nuk duhet të mbani fëmijën në shtëpi përveç nëse ekziston një arsye e fortë - për shembull nëse ata janë të sëmurë - dhe ju e keni njoftuar shkollën. Shkollat monitorojnë nga afër frekuentimin dhe ata do të ndërmarrin veprime, nëse fëmija nuk shkon në shkollë pa një aprovim paraprak ose një arsye të fortë. Kjo mund të përfshijë vendosjen e gjobave ose urdhrave gjyqësor për prindërit. Pra, nëse fëmija juaj nuk mund të shkojë në shkollë, ose do të shkojë me vonesë, është shumë e rëndësishme, që ju të telefononi shkollën deri në orën 08:30 në mëngjes, për të shpjeguar pse. Ju duhet të gjeni numrin për të telefonuar dhe për të mësuar se si të thoni në anglisht: Fëmija im (emri) nuk mund të vijë në shkollë sot sepse është sëmurë ". Cdo mungesë jashtë pushimeve të caktuara shkollore duhet të aprovohet nga shkolla.

Të gjitha Shkollat ofrojnë një kurrikul bazë mësimdhënie të vendosur nga qeveria. Cdo shkollë gjithashtu ofron lëndë dhe veprimtari të tjera. Librat shkollore sigurohen falas nga shkolla.

Të gjithë fëmijët duhet të veshin uniformën e shkollës. Ju mund ta blini uniformën të re ose të përdorur, dhe disa shkolla, këshilla lokal dhe shoqata bamirëse mund të ofrojnë ndihmë për shpenzimet.



Nëse merrni mbështje të llojit S95, ofruar nga Zyra e Punëve të Brendshme (Home Office), fëmija juaj ka të drejtë për ushqim falas në shkollë. Për ata që kanë mbështetje të llojit S4, kjo është në varësi të shkollës dhe këshillit vendor.

Këshillat vendor ofrojnë transport falas për të shkuar në shkollë, për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore ose që kanë probleme me lëvizshmërinë. Të tjerët mund të kualifikohen nëse janë nën 8 vjeç, dhe jetojnë më shumë se 2 milje larg nga shkolla e tyre më e afërt, dhe 3 milje nëse janë më të vjetër. Nëse fëmija juaj përdor autobus ose tren për të shkuar në shkollë, ju mund të zvogëloni kostot, duke blerë një abone për moshat nën 16 vjeç.

Fëmijët me probleme të lëvizshmërisë ose me nevoja të veçanta arsimore, do të vlerësohen dhe do të marrin mbështetje për nevojat e tyre speciale arsimore. Shkollat do të organizojnë gjithashtu mbështetje gjuhësore shtesë, për fëmijët që nuk flasin anglisht.

Për tu siguruar që fëmijët do të përqendrohen në të mësuar dhe të marrin pjesë plotësisht në shkollë, këshillohet që fëmijët e vegjël të flenë gjumë për rreth 11 dhe 12 orë çdo natë, dhe fëmijët më të vjetër rreth 9 orë.

Cdo shkollë ka orarin e saj të mësimin, uniformën shkollore, lëndë dhe aktivitete me zgjedhje. Kontrolloni faqen e internetit të shkollës suaj për detaje dhe gjithmonë përpuni të lexoni gazetat e tyre, për t'ju siguruar që fëmija juaj të mos humbasë aktivitete ditore dhe aktivitete të veçanta.

Shkollat inkurajojnë të gjithë prindërit të krijojnë një marrëdhënie të ngushtë me ta, për të mbështetur përparimin e fëmijës. Ju mund të flisni me mësuesit kur i dërgoni ose merrni fëmijën tuaj nga shkolla, dhe duhet të merrni pjesë në Takimet e Prindërve, ku mund të diskutoni për përparimin e fëmijës tuaj me mësuesit, të bëni ndonjë pyetje dhe të diskutoni ndonjë shqetësim.

Më shumë informacion mund të gjeni në <https://www.gov.uk/browse/childcare-parenting/schools-education>

Shkollat fillore (për fëmijët 5 deri në 11 vjeç) presin që prindërit ta shoqërojnë fëmijën e tyre në shkollë dhe t'i marrin nga shkolla. Cdo shkollë ka politikën e vet për të konsideruar se kur është e sigurt që një fëmijë të jetë i pashoqëruar. Do të duhet të informoni shkollën nëse vendosni që dikush tjetër do të marrë fëmijën tuaj nga shkolla, pasi shkollat nuk lejojnë kurrë një fëmijë të largohet me një të huaj.

Kjo mund të jetë në kundërshtim me atë që është normale në vendin tuaj, ku fëmijëve mund t'u jepet përgjegjësi në një moshë më të hershme. Por është shumë e rëndësishme të kuptohet ndryshimi me Mbretërinë e Bashkuar.



Shkolla fillore: Moshë 5 deri 11 (Deri në Vitin e 6)

Fëmijët fillojnë shkollën fillore, në vitin shkollor kur ata bëjnë 5 vjeç. Ata fillojnë me klasat parashkollore, pastaj klasat quhen Viti 1 deri në Vitin e 6. Fëmijët bëjnë Teste Kombëtare të Vlerësimit Standard - të njohura si SAT - në Vitet 2 dhe 6. Rezultatet mund të përdoren për të vendosur fëmijët në grupe me lëndët ku kanë rezultate më mira, kur ata shkojnë në Shkollën e Mesme.



Fëmijëve do t'u jepen detyra shtëpie dhe pritet që prindërit t'i mbështesin ata për t'i dorëzuar ato në kohë. Do të jetë e vështirë për prindërit me anglishte të kufizuar, për të ndihmuar fëmijët e tyre, kështu që ju mund të pyesni shkollën nëse ata kanë një klub të detyrave të shtëpisë, ose nëse ka një grup në komunitetin lokal që ofron mbështetje për detyrat e shtëpisë. Prindërit gjithashtu mund të kualifikohen për kurse falas, që zhvillohen në një kolegjet lokale, përfshirë anglisht, shkrim leximi dhe matematikë.

Mësuesit shpesh u kërkojnë fëmijëve të marrin një letër në shtëpi për t'ua dhënë prindërve të tyre, përfshirë detaje të detyrave të shtëpisë. Gjithmonë kontrolloni me fëmijën tuaj pasi ata mund ta harrojnë.

Shkolla e mesme: Moshë 11 deri 16 (Viti 7 deri vitin 11)

Fëmijët fillojnë shkollën e mesme në vitin shkollor, kur ata mbushin 11 vjeç, duke filluar në vitin 7 dhe duke mbaruar në Vitin 11, kur të mbushin 16 vjeç. Vendet nuk janë ndarë automatikisht për fëmijët, kështu që prindërit duhet të aplikojnë për shkollat e tyre të preferuara. Pyetni Shkollën Fillore të fëmijës suaj ose Ekipin e Minoriteteve Etnike të Këshillit Lokal për t'ju ndihmuar në procesin e aplikimit dhe të shpjegoni se si merren vendimet.

Në Vitin 9, kur fëmija juaj është 13 ose 14 vjeç, ata do të duhet të zgjedhin se cilat lëndë të studiojnë për Certifikatën e Përgjithshme Kombëtare të Provimeve të Arsimit të Mesëm - të njohur si GCSE. Këto provime janë në vitin 11 kur fëmijët janë 15 ose 16 vjeç. Fëmijët zakonisht marrin nga 7 deri në 12 lëndë. Lëndët e zgjedhura dhe notat e arritura mund të përcaktojnë studimet dhe karrierën e tyre të ardhshme, siç është Kolegji i Formës së 6-të, lëndët e nivelit të avancuar dhe kurse universitare për të cilat ata mund të aplikojnë. Notat e dhëna nga GCSE shkojnë nga 9 (më e larta) deri në 1 (më e ulta). Të gjitha Shkollat e Mesme ofrojnë udhëzime të pavarura All për karrierë, për t'i mbështetur fëmijët të bëjnë zgjedhje për të ardhmen e tyre.



Detyrat e shtëpisë rriten në rreth 2 deri në 3 orë në ditë midis moshave 14 dhe 16 vjeç, për të ndihmuar në përgatitjen e provimeve GCSE. Kontrolloni nëse shkolla ka një klub të detyrave të shtëpisë, pas shkolle, pasi do t'i japë fëmijës tuaj qasje në burimet e të mësuarit dhe në internet. Nëse një fëmijë vazhdimisht nuk arrin të bëjë detyrat e shtëpisë, shkolla do të kontaktojë prindërit për të diskutuar se si t'i përmirësojnë gjërat.

Mbroni fëmijën tuaj nga bulzimi, urrejtja dhe abuzimi në internet

Inkurajoni fëmijën tuaj të ndajë ndonjë shqetësim për mënyrën e trajtimit të fëmijëve të tjerë në shkollë.


Nëse një fëmijë tjetër është në shënjestër të tyre, për t'i lënduar ata fizikisht ose emocionalisht, kjo quhet "bulzëm". Nëse ata janë në shënjestër për shkak të racës ose fesë së tyre, kjo quhet "Urrejtje". Të dy dëmtojnë mirëqenien e fëmijës dhe duhet të ndalen. Ju nuk duhet të përpiqeni ta zgjidhni vetë këtë shqetësim, duke iu afruar fëmijës tjetër ose prindërve të tij. Ju duhet të bisedoni me Mësuesin e klasës për t'i bërë ata të vetëdijshëm për çfarë po ndodh dhe të diskutoni se çfarë veprimesh mund të



ndërmarrë shkolla për të parandaluar që të ndodhë përsëri. Të gjitha shkollat kanë një politikë sjelljeje dhe një detyrë të kujdesit për fëmijën tuaj. Nëse abuzimi përsëritet, kërkon që të flisni me drejtorin e shkollës. Ju gjithashtu mund të flisni me policinë, veçanërisht për abuzime më serioze siç janë dhuna, vjedhja, frikësimi, ngacmimi dhe krimi i urrejtjes. Ju mund të raportoni krimin e urrejtjes në polici duke telefonuar në numrin e telefonit 101, juve nuk do t'ju kërkojë të jepni emrin tuaj, kur ju do të raportoni një incident që lidhet me krimin e urrejtjes. Raportimi do të jetë absolutisht konfidencial. Për më shumë këshilla, se si prindërit mund ta mbrojnë fëmijën e tyre nga bulzimi kërkon në [https:// www.bullying.co.uk/bullying-at-school/advice-on-contacting-your-child-s-school-about-bullying/](https://www.bullying.co.uk/bullying-at-school/advice-on-contacting-your-child-s-school-about-bullying/)

Forma 6 / Kolegji (Viti 12 dhe 13)

Midis moshave 16 dhe 18 vjeç, fëmija duhet të jetë në një formë edukimi ose formimi. Shumë fëmijë kalojnë në Formën 6, për të studiuar për provimet kombëtare të Nivelit të Avancuar të njohur si Nivele A. Këto kërkojnë për të hyrë në kurse të diplomës në Universitet. Shumica e studentëve marrin 3 nivele A, që është minimumi që Universitetet kërkojnë të ofrojnë një vend. Provimet janë në fund të vitit 13. Notat vlerësohen në një shkallë A * në E, me A * që është më e larta dhe shkalla C konsiderohet si notë kaluese. Fëmijë të tjerë shkojnë në Kolegj për të studiuar për kualifikime profesionale, duke përfshirë praktikë dhe trajnime, të cilat kombinojnë trajnime në punë dhe aftësi të bazuara me punën e kursit. Ose ata mund të bëjnë 20 orë ose më shumë në javë, në punë ose vullnetarisht, ndërkohë që janë në arsim ose trainim me kohë të pjesshme.



kursit. Ose ata mund të bëjnë 20 orë ose më shumë në javë, në punë ose vullnetarisht, ndërkohë që janë në arsim ose trainim me kohë të pjesshme.

Pas 18: Universiti, Kolegjet e Edukimit të Mëtejshëm, Vullnetarizmi

Azilit kërkesit nuk kanë të drejtë të jenë pjesë e skemës kombëtare të Kredisë Studentore, kështu që ata nuk do të jenë në gjendje të përballojnë tarifën e Universitetit, që janë rreth 9,000 stërlina çdo vit. Sidoqoftë, disa Universitete ofrojnë bursa studentore pa pagesë. Meqë Azilit kërkesit nuk lejohen të punojnë, ju mund ta ndihmoni fëmijën të gjejë mundësi për të punuar vullnetarisht pa pagesë. Kjo do t'i bëjë ata të angazhohen në kohën e lirë, ndërsa presin, dhe gjithashtu mund të sigurojë referenca të rëndësishme personale. Vullnetarizmi është shumë i respektuar nga universitetet dhe punëdhënësit e ardhshëm. Azilkërkesit gjithashtu mund të kenë të drejtë të studiojnë kurse akademike dhe profesionale në Kolegjet e Edukimit të Mëtejshëm.



UNIVERSITY OF
SANCTUARY AWARD
WELCOMING ASYLUM SEEKERS AND REFUGEES